



Nr. ____ .Prot., datë, ____ / ____ /2025

Nr. 1541.Prot., datë, 07/05 /2025

MARRËVESHJE

për

BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

ndërmjet

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Dhe

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Adrian Civici dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimeve të shumanshme në funksion të zhvillimit institucional.

I

Bashkëpunimi ndërmjet të dy universiteteve do të përfshijë:

- shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor;
- shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore shkencore;
- nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore;
- nxitjen, mbështetjen dhe realizimin veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);

- e) shkëmbimin e literaturës shkencore;
- f) shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional.

II

Të dy universitetet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe të potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (I/a-f) dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, ngrihet një Komision i Përbashkët i përbërë nga Rektori ose i ngarkuari i tij dhe dy profesorë të tjerë, nga secili universitet. Të dyja palët caktojnë një person kontakti për të mundësuar zbatimin e shpejtë të kësaj marrëveshje.

Për Universitetin mesdhetar të Shqipërisë:

Elton Skendaj

elton.skendaj@umsh.edu.al

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës:

Endrit Kullaj

III

Çdo nen i kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy universiteteve.

IV

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, kur të dy universitetit janë dakord për këtë. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga universiteti i interesuar të paktën 3 muaj përpara përfundimit të saj.

Për **Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë**

REKTORI

Prof. Dr. Adrian CIVICI

Për **Universitetin Bujqësor të Tiranës**

REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU